

POP

**PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE**



ZGJEDHJET VENDORE 14 MAJ 2023

KONTRATA SOCIALE



ELBASAN

KONTRATA SOCIALE 2023 – 2027 BASHKIA ELBASAN

Përballja e Ofertave Politike (POP), është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare, të cilat punojnë në 12 bashki të Shqipërisë. Në bashkinë Elbasan, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj realizohet nga organizata “Tjetër Vizion”. Tjetër Vizion është një organizatë me eksperiencë 20 vjeçare në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut dhe ofrimit të shërbimeve sociale për target grupet në nevojë.

Kontrata sociale hartohet nga POP në çdo fushatë elektorale gjatë Zgjedhjeve Vendore në Shqipëri. Kontrata sociale prezantohet te të gjithë kandidatët për kryetar bashkie gjatë periudhës së fushatës elektorale.

Në hartimin e kontratës sociale 2023-2027 janë marrë parasysh kërkesat dhe nevojat e grupeve të ndryshme të qytetarëve brenda territorit të Bashkisë së Elbasanit, me një fokus të veçantë për grupet e cenushme.

PRIORITETET KRYESORE

Prioriteti 1. Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integrimit evropian në nivel vendor

- Hartimi i një raporti vjetor në lidhje me arritjet në zbatim të Strategjisë për Decentralizim dhe Vetëqeverisje Lokale 2023-2030.
- Sigurimi i përfaqësimit, udhëheqjes, planifikimit dhe vendimmarrjes demokratike dhe efektive në linjë me objektivat specifike të Strategjisë për Decentralizim dhe Vetëqeverisje Lokale 2023-2030.
- Të sigurohet përfshirja sistematike e komunitetit në veprimtarinë dhe në vendimmarrjen e këshillit bashkiak, si dhe në monitorimin e zbatimit të politikave vendore.
- Bashkia të japë informacion të plotë në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me projektet e financuara nga BE-ja dhe çdo donator tjetër në faqen zyrtare të saj.
- Forcimi i qeverisjes së mirë në nivelin vendor, sipas 4 objektivave specifike të Strategjisë për Decentralizim dhe Vetëqeverisje Lokale 2023-2030: (i) sigurimi i qeverisjes së hapur, rritjes së transparencës, përgjegjshmërisë dhe shtrirjes më të madhe të e-qeverisjes në nivel vendor; (ii) Integrimi Evropian dhe qeveria vendore; (iii) forcimi i strukturave komunitare në nivel vendor (Komisionet qytetare, Kryetarët e fshatrave, Ndërlidhësit qytetarë); (iv) adoptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore).
- Zyrat e Njësive Administrative të shërbejnë edhe si zyra informimi për çdo ndryshim ligjor apo dhe udhëzim ose/dhe vendime të Këshillit Bashkiak që prekin drejtpërdrejt interesat e qytetarëve.

- Bashkia duhet të ndërmarrë hapa për të përmirësuar strategjitë e saj të informacionit dhe komunikimit në lidhje me promovimin e biznesit dhe programet e punësimit. Ka një numër të konsiderueshëm të qytetarëve të interesuar që aktualisht nuk janë në dijeni të këtyre programeve, duke vënë në pah nevojën për një komunikim më të mirë.

Prioriteti 2. Drejtësia Sociale

- Ngritja e një qendre të re komunitare multifunkionale në qytetin e Elbasanit (përveç atyre ekzistuese siç është Qendra Balashe dhe qendra rinore RIEMAR) ku të përfitojnë jo vetëm të rinjtë por edhe moshat e treta.
- Mbështetje në programe të riintegritit të Viktimave të Trafikimit dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit që dalin nga shërbimet rezidenciale dhe nuk kanë mundësi të riintegrohesh në familje. (prioritet në punësimin dhe strehimin e tyre)
- Lehtësim dhe mbështetje e grave të dhunuara, grave të vetme, viktimave të trafikimit ose kryefamiljare në aplikimin për procedurat e përfitimit të bonusit të qerasë.
- Për gratë me Urdhër Mbrojtje dhe/ose Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes, përveç pagesës që u akordohet në bazë të vendimit të gjykatës, të marrin shërbim pa pagesë për çerdhet dhe kopshtet e fëmijëve të tyre.
- Shkollat e targetuara si komunitare të jenë të hapura për fëmijët, të rinjtë dhe komunitetin gjatë pasditeve dhe të mirëmbahen e të ruhen nga roje të bashkisë.
- Ngritja dhe funksionimi i një qendre rehabilituese dhe riintegruese për përdoruesit e lëndëve narkotike.
- Ngritja e një kopshti alternativ në qytetin e Elbasanit, që do të funksionojë nga ora 13:00 deri në 17:00, për të ofruar një mjedis të sigurtë dhe mbështetës për fëmijët e grave të dhunuara, nënave beqare ose kryefamiljare që punojnë me orë të zgjatura dhe nuk janë në gjendje të kujdesen për fëmijët e tyre gjatë kësaj fashe orare.
- Adresimi i dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit të qenieve njerzore. Krijimi i një databaze me të gjitha rastet e raportuara dhe që trajtohen pranë drejtorisë së shërbimit social në Bashkinë e Elbasanit.
- Të hartohet plani i ri i përfshirjes sociale të bashkisë 2023-2027, me ndihmën e organizatave të shoqërisë civile dhe donatorëve si dhe në bashkëpunim me drejtorinë e shërbimit social të bashkisë.
- Hartimi i një programi koordinues, kontakte periodike, sesione/workshope informuese për Punonjës Socialë, Psikologë, Punonjës Sigurie në shkolla në bashkëpunim me Njësinë për mbrojtjen e fëmijëve dhe organizatat e shoqërisë civile që operojnë në këtë fushë, për identifikimin dhe trajtimin e hershëm të rasteve të dhunës, shfrytëzimit seksual, rekrutimit online si dhe trafikimit të fëmijëve.

Prioriteti 3. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor

- Krijimi i mundësive për promovimin e agroturizmit dhe zejtarisë duke njohur kontributin e grave, vajzave dhe të rinjve.

- Krijimi i një hapësire tregtare për gratë artizane të Elbasanit, brenda “Kalasë së Elbasanit” apo në vende të tjera publike që vizitohen nga turistët.
- Ngritja dhe funksionimi i një pike grumbullimi në Njësinë Administrative Tregan – Gjinar, për frutat dhe perimet në mënyre që banorët ti tregtojnë lehtësisht ato dhe përfitojnë ekonomikisht.
- Në bashki duhet të funksionojë edhe një zyrë koordinuese me zyrën e punës për të analizuar më mirë ofertat e punës për të rinjtë dhe gratë e regjistruara në zyrat e punës, me adresën se ku ofrohet puna, sepse largësia e madhe shpesh i pengon ato të pranojnë punësimin. Kjo zyrë koordinuese të bashkëpunojë me Njësitë Administrative për të tërhequr sa më shumë të rinj dhe gra.

Prioriteti 4. Transport publik i aksesueshëm dhe i sigurtë për të gjithë qytetarët e Elbasanit.

- Ndërtimi i vendqëndrimit të autobusëve për linjat e transportit në zonat rurale të Njësie Administrative.
- Afishimi i stacioneve dhe orareve në vendqëndrimet e autobusëve në të gjitha njësitë administrative të Elbasanit.
- Shtimi i orarit të shërbimit të transportit deri në orën 18:00 në të gjitha linjat drejt njësie Administrative.
- Rinovim i flotës së transportit publik të qytetit me autobusë të rinj që plotësojnë standardet për ndotjen mjedisore dhe ofrojnë shërbim normal gjatë dimrit me ngrohje dhe verës me ventilim.
- Pajisja me abone për transportin publik do t'u ofronte lehtësi ekonomike të rinjve që ndjekin kurse profesionale, trajnime për punë ose punojnë në sektorë të ndryshëm.

Prioriteti 5. Rivitalizimi i qendrës së fshatit Gjinar (Fushë-Kuqe)

Prioriteti 6: Qendra e Njësisë Administrative Tregan, një destinacion popullor për turistët shëndetësorë që vizitojnë llixhat, kërkon pastrim më të shpeshtë dhe kosha mbeturinash në të dy skajet për një mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm.

Prioriteti 7. Rikonstruksioni i shkollës Naim Frashëri, Elbasan dhe shkollës 9-vjeçare të Njësisë Administrative Tregan

Prioriteti 8. Aktivizimi i nderjes në kohë të kaldajave gjatë periudhës së dimrit në të gjitha shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të Elbasanit në të gjitha ato raste kur ky sistem është i instaluar në shkolla.

PRIORITETE TË TJERA

Prioriteti 9. Shkollat, Kopshtet dhe Çerdhet

- Shtimi i mjediseve sportive dhe argëtuese për fëmijët dhe të rinjtë, si p.sh. ndërtimi i një palestre në shkollën 9-vjeçare “Sulë Harri”, “Qamil Guranjaku” dhe “Jeronim Derada”.
- Ngritja e laboratorëve demonstrues dhe mësimorë për rregullat e qarkullimit rrugor, ruajtjen e energjisë, serave etj.
- Të ndërtohen ambiente të përshtatshme për fëmijë, si lulishte dhe kënd sportiv pranë shkollës në Njësinë Administrative Gjergjan.

Prioriteti 10. Qendrat Shëndetësore

- Rikonstruksioni i qendrës shëndetësore në Kacivel, e cila aktualisht nuk plotëson asnjë kusht për ofrimin e shërbimit. Me këtë ndërhyrje përfitojnë edhe fshatrat përreth.
- Bashkia të kujdeset që të gjitha qendrat shëndetësore të bashkisë të jenë të pastruara, të lyera, të kenë furnizim me ujë të ngruhtë dhe të ftohtë.
- Vendosja e sinjalistikave treguese ku është e lokalizuar qendra shëndetësore për të gjitha njësitë e tilla në Bashkinë Elbasan.

Prioriteti 11. Pastrimi dhe Mbetjet Urbane

- Vendosja e koshave të mbetjeve urbane ose ndërtimi i vend grumbullimeve në një prej fshatrave më të mëdhenj të Njësisë Administrative Gjinar, në Lleshan. Aktualisht mbetjet asgjësohen me djegje nga vetë banorët ose hidhen në përrenj. E njëjta situatë është edhe në fshatra të tjerë të kësaj njësie administrative.
- Pastrimi i mbetjeve urbane në njësinë Gjergjan të bëhet në mënyrë periodike dhe të shpeshtë (aktualisht shërbimi ofrohet 1 herë në 10 ditë)
- Të ndërtohen vend grumbullime për mbetjet në njësitë administrative rurale ku mungojnë koshat e plehrave dhe nuk ka mundësi të vendosen për shkak të terrenit.

Prioriteti 12. Uji i pijshëm dhe kanalizimet

- Kërkohet përmirësimi i sistemit të ujit të pishëm në fshatrat e Njësisë Administrative Gjinar.
- Përmirësimi i sistemit të ujit të pishëm në fshatrat e Njësisë Administrative Tregan.
- Kërkohet furnizimi me ujë të pijshëm 24 ore për banorët e qytetit të Elbasanit.
- Sistemi i kanalizimeve ka nevojë për ndërhyrje në njësitë administrative Tregan dhe Gjergjan.
- Të investohet në sistemin e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza pasi aktualisht derdhen në përrenj.

Prioriteti 13. Infrastruktura rrugore

Kërkohej ndërhyrje sipas zonave:

Njësia administrative Nr 1

- Vendosja e barrierave në rrugën “Kozma Naska”, si dhe në rrugën e sapo rikonstruktuar të ish konservimit.

Njësia administrative nr. 2

- Në lagjen “28 nentori”, rikonstruksioni i rrugëve ndërmjetëse si Rruga “17 Marsi” dhe Rruga “Aleks Buda”
- Përmirësimi i ndriçimit në rrugët e lagjes “28 Nentori” dhe ish konservimit.
- Përmirësimi i ndriçimit në disa lagje periferike të qytetit të Elbasanit.

Njësia administrative Gjinar

- Lobimi nga bashkia pranë ARSH-së për rehabilitimin e rrugës lidhëse Elbasan – Gjinar e cila do të ndikojë drejtpërdrejt në turizmin e zonës.
- Lobimi nga bashkia pranë ARSH-së për instalimin e ndriçimit rrugor në rrugën kryesore Elbasan – Gjinar, mungesa e të cilit sjell pasoja në aksidente të mundshme.

Njësia administrative Gjergjan

- Për të ofruar siguri në rrugë në segmente të caktuara të rrugës kryesore të kësaj njësie, bashkia të vendosë barriera në aksin kryesor të rrugës.

Njësia administrative Tregan

- Përmirësimi i Rrugëve lidhëse të fshatrave të njësisë me qendrën e Treganit (shumica e tyre janë me çakull ose shumë të amortizuara)
- Instalimi i ndriçimit në këto rrugë pasi mungon totalisht.
- Të rikonstruktohet rruga e fshtatit Shilbater pasi lidh 4 fshatra të Njesisë Administrative si dhe rruga e fshatit Kacivel.

Njësia administrative Labinot –Fushë

- Lobimi nga bashkia pranë ARSH-së për ndriçimin e zonës së Mengelit në rrugën kryesore nacionale. Emergjente lidhja e ndriçimit sidomos përgjatë gjithë segmentit të banuar.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Pogradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;



- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

